



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE

Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 552 126 ext. 101 \* E-mail: [fim@uni-pr.edu](mailto:fim@uni-pr.edu) \* [www.fim.uni-pr.edu](http://www.fim.uni-pr.edu)Nr. Prot.: 461Datë: 25/03/2025

## RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Komunikacion Rrugor
Titulli i punimit	<i>Analiza e aksidenteve të trafikut në rajonin e Prizrenit për periudhën kohore 2018-2021 “</i>
Kandidati	Bsc. Arben Mujaj
Mentori	Prof. Dr. Naser Lajqi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshilin e Fakultetit	Datë: 24.10.2022 Vendimi Nr.: <b>3068/2-14</b>

Vlerësimi i dorëshkrimit.

Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me numër 3068/2-14 të datës 14.12.2022 është formuar komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Ferat SHALA, kryetar
2. Prof. Dr. Naser LAJQI, mentor
3. Prof. Asoc. Dr. Ramazan MAZREKAJ, anëtar

Për vlerësimin e punimit të diplomës të nivelit master, me titull “ **ANALIZA E AKSIDENTEVE TË TRAFIKUT NË RAJONIN E PRIZRENIT PËR PERIUdhËN KOHORE 2018-2021**”

( **ANALYSIS OF TRAFFIC ACCIDENTS IN THE PRIZREN REGION FOR THE PERIOD 2018-2021** ).

Pas kontrollimit të punimit të lartëpërmendur Komisioni jep këtë:

### RAPORT

Punimi i masterit me titull “ Analiza e aksidenteve në rajonin e Prizrenit për periudhën kohore 2018-2021”, të kandidatit Bsc. Arben Mujaj, është hartuar në gjithsej 6 kapituj bazë. Punimi përmban edhe rekomandimet, përfundimin dhe literaturën e shfrytëzuar. Punimi i ka gjithsej 109 faqe, 58 figura dhe 3 tabela.

Në këtë punim janë identifikuar, analizuar, studiuar dhe prezantuar 80 raste me aksidente, të cilat kanë ndodhur në rajonin e Prizrenit, për periudhën kohore 2018-2021.

## Formulari – F3

Në kapitullin e parë **“Hyrje”** janë prezantuar; identifikimi dhe përshkrimi i problemit, qëllimi i hulumtimit për lëndët e aksidenteve në komunikacion në rajonin e Prizrenit për periudhën kohore 2018 – 2021.

Në kapitullin e dytë **“Regjioni i Prizrenit në përgjithësi, planifikimi hapësinor dhe infrastruktura”**, janë paraqitur të dhënat që kanë të bëjnë me Infrastrukturën kryesore dhe planifikimin hapësinor, në komunën e Prizrenit, Suharekës dhe Dragashit.

Në kapitullin e tretë **“ Faktorët e sigurisë në komunikacion dhe karakteristikat e tyre”**, janë përmendur faktorët kryesorë që ndikojnë në aksidente dhe elementet e secilit faktor. Gjithashtu janë shqyrtuar karakteristikat e veçanta të këtyre faktorëve, duke filluar nga faktori njeri, rrugë, automjet dhe mjedis.

Në kapitullin e katërt **“ Procedura e hulumtimit të lëndeve të aksidenteve në komunikacion në periudhën kohore Janar 2018 – Dhjetor 2021 në gjykatën themelore në Prizren”**, është treguar mënyra e procedimit të lëndeve gjyqësore duke filluar nga pranimi deri ne egzekutimin e tyre. Është përshkruar metoda e mbledhjes së të dhënave dhe marrja e mostrave për shqyrtim. Janë klasifikuar aksidentet sipas pasojave, shkakut, llojit të përplasjes, vendndodhjes dhe kohës. Ku sipas mostrave të marra, janë paraqitur në mënyrë grafike këto klasifikime të aksidenteve.

Në kapitullin e pestë **“ Analiza statistikore e lëndeve të aksidenteve në komunikacion në gjykatën themelore në Prizren gjatë periudhës kohore Janar 2018 – Dhjetor 2021”**, janë paraqitur lokacionet e aksidenteve sipas mostrave të shqyrtuara, për secilin vit të shqyrtimit. Në bazë të hartës së krijuar, janë identifikuar rrugët dhe udhëkryqet më të shpeshta në të cilat kanë ndodhur aksidentet, të cilat janë quajtur si rrugë me rrezikshmëri të lartë. Pastaj për këto rrugë përmes fotografive të bëra, janë analizuar veprimet që duhet të merren më qellim të zvogëlimit të numrit të aksidenteve në këto rrugë.

Në kapitullin e gjashtë **“ Rastet studimore të aksidenteve”**, janë analizuar dy aksidente në detaje, duke dhënë konstatimet dhe mendimin përfundimtar për lëshimet e pjesëmarrësve në aksident. Rasti i parë studimor, është aksident i cili ka ndodhë në rrugë brenda zonës urbane të qytetit të Prizrenit dhe rasti i dytë studimor, është aksident i cili ka ndodhur në rrugë jashtë zonës urbane të qytetit të Prizrenit. Rastet për studim janë përzgjedhur, bazuar në rrugët me rrezikshmëri të lartë të identifikura në kapitullin e pestë.

Në fund të punimit janë dhënë **“ Rekomandimet” dhe “Përfundimi”**, që kanë për qëllim zvogëlimin e numrit të aksidenteve në qytetin e Prizrenit. Gjithashtu është dhënë edhe literatura e përdorur për hartimin e këtij punimi të diplomës.

## PËRFUNDIM

Në bazë të shqyrtimit të punimit Master, komisioni për vlerësim konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i shtjelluar përmes figurave dhe tabelave.

Prandaj, Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidatit Bsc. Arben Mujaj, me titull “**Analiza e aksidenteve të trafikut në rajonin e Prizrenit për periudhën kohore 2018-2021**”, mendon se i plotëson të gjitha kriteret për punim Master dhe propozon që të jepet në diskutim publik.

### *Praktika profesionale*

Kandidati Bsc. Arben Mujaj ka përfunduar praktikën profesionale në Gjykatën Themelore në Prizren – Divizioni për kundërvajtje prej datës 31.12.2022 deri më datën 31.01.2023.

Kandidati ka dorëzuar Ditarin e Praktikës profesionale me datë 21.03.2025 permes e-mail të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Anëtarët e komisionit e kanë vlerësuar me sukses punimin e ditarit të praktikës profesionale, ndërsa vendosja e notes **kalo** në SEMS do të bëhet pas paraqitjes së Praktikës si lëndë.

Prishtinë: 24/03/2025

Komisioni:

1. Prof. Dr. Naser LAJQI

\_\_\_\_\_ - mentor

2. Prof. Asoc. Dr. Ferat SHALA


\_\_\_\_\_ anëtar

3. Prof. Asoc. Dr. Ramadan MAZREKAJ

\_\_\_\_\_ - anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE**  
**DEPARTAMENTI: KOMUNIKACION RRUGOR**



**PUNIM DIPLOME MASTER**  
**“ANALIZA E AKSIDENTEVE TË TRAFIKUT NË RAJONIN E**  
**PRIZRENIT PËR PERIUDHËN KOHORE 2018-2021”**

Mentori:

Prof. Dr. Naser Lajçi

Kandidati:

Bsc. Arben Mujaj

PRISHTINË 2025

## PËRMBLEDHJA ( ABSTRAKTI )

Përmes këtij punimi, synohet që të kontribuohet në hulumtimin e shkaktarëve të aksidenteve në rajonin e Prizrenit. Këtë duhet arritur përmes njohjes ( identifikimit ) të problemeve më të shpeshta me të cilat ballafaqohet komunikacioni në këtë rajon, duke vazhduar me shqyrtimin e mundësive për përmirësimin e gjendjes aktuale.

Hulumtimi kryesisht bazohet në lëndët e aksidenteve në komunikacion të trajtuara nga gjykata themelore në Prizren, divizioni për kundërvajtje. Hulumtimi ka për bazë lëndët e aksidenteve që kanë ndodhur në këtë regjion, veçanërisht në ato komuna të cilat i përfshin gjykata themelore në Prizren ( Prizren, Suharekë dhe Dragash ) gjatë periudhës 4 vjeçare, Janar 2018 deri në Dhjetor 2021, për të cilat do të bëhen analiza statistikore e bazuar në disa parametra që vërehen gjatë hulumtimit.

Fokusi kryesor i këtij studimi bazohet në lëndët gjyqësore, duke filluar nga identifikimi i numrit të lëndëve të trajtuara për secilin vit, gjatë periudhës kohore të larte cekur nga Gjykata Themelore në Prizren, përpunimi statistikor i aksidenteve sipas natyrës së lëndimeve (të lehta, të renda dhe me fatalitet), klasifikimi i lëndëve sipas shkaktarëve apo faktorëve të aksidentit (njeriu, rruga, automjeti, kushtet atmosferike, etj.). Gjithashtu mendohet të krijohet një metodë më e përshtatshme për klasifikimin e lëndëve të aksidenteve, bazuar në rezultate të statistikave, aplikimin e masave parandaluese për zvogëlimin e numrit të aksidenteve, dinamikën dhe procedurat e trajtimit të lëndëve të aksidenteve duke filluar nga çasti i aksidentit, deri në dhënien e vendimit final.

Në punim, janë trajtuar 80 lëndë, për secilin vit është marrë mostra për rreth 20 lëndë. Këto lëndë janë klasifikuar sipas pasojave, shkakat, formës së përplasjes së automjetit dhe sipas vendndodhjes. Për secilin vit është krijuar harta zonale e vendndodhjes së aksidenteve. Pas identifikimit të rrugëve dhe kryqëzimeve, janë vizituar lokacionet e tilla për t'i identifikuar faktorët e rrezikut dhe për t'i marrë masat parandaluese për evitimin e aksidenteve.